

Gazmend SHPUZA

SHQIPTARËT DHE BETEJA E FUSHË KOSOVËS

Beteja e Kosovës e vitit 1389 është një temë e rrahur më së tepërmi në historiografinë serbe. Dhe ajo shqiptare është marrë me te. Ka vend për t'iu kthyer asaj sepse bien ë sy që të dhënat e burimeve osmane sidomos trajtimet e historiografisë turke nuk janë pasur shumë parasysh.

Më 28 qershor 1389 (sipas kalendarit të vjetër, më 15 qershor)¹ në Fushë Kosovë, midis Prishtinës dhe lumit Llap, është zhvilluar një nga betejat më të përgjakshme të kohës së mesjetës në këto treva dhe më gjerë. Aty u vunë përballë njeri tjetrit ushtritë e një koalicioni të gjerë popujsh të Ballkanit, nën udhëheqjen e knjazit Llazar Hrebljanoviq, në të cilin merrnin pjesë gjerësisht dhe shqiptarët, nga njëra anë, dhe forcat e turqve osmanë, nga ana tjetër. Vlen të theksohet një fakt, i cili shpesh injorohet, sidomos nga autorët serbë, jo pa qëllim, që përkrah sulltan Muratit qenë rreshtuar dhe shumë vasalë të krishterë, midis të cilëve dhe sllavë, e madje dhe serbë. Ajo ka hyrë në histori me emrin Beteja e Kosovës, apo Lufta e Fushë Kosovës.

Në historinë e popujve ka, siç pranohet nga të gjithë, shumë momente dhe ngjarje të rëndësishme që tërheqin vëmendjen e historianëve dhe studiuesve të ndryshëm. Vëmendje të veçantë kërkojnë ato ngjarje që shënojnë pikë kthese në zhvillimin e mëtejshëm historik të trevave përkatëse. Ngjarje e një rëndësie të tillë është dhe Beteja e Fushë Kosovës e zhvilluar në afërsi të Prishtinës 600 e sa vjet më parë. Në historinë e këtyre popujve kjo betejë shënon pikën kulmore të qëndresës së tyre të përbashkët përballë rrezikut të invazionit osman.² Pas saj dështuan jo vetëm përpjekjet

¹ Sipas Süleyman Külçe. *Osmanlı tarihinde Arnavutluk*, İzmir [Yeni Asır matbaas] 1944, 40, të mbështetur me sa duket të Hayjrettin Tarihi, kitap 4, s. 84, beteja është zhvilluar ditën e martë më 15 shaban 791 H.

² Luan Malltezi, *Beteja e Fushë - Kosovës dhe (1389) dhe shqiptarët*, Tiranë: Eurorilindja,

e përbashkëta, por asnjë nga këto popuj nuk qe në gjendje, përveç popullit shqiptar të udhëhequr nga Skënderbeu, të vijojë qëndresën e vet. Fuqia e Perandorisë Osmane ishte në rritje. Përballë saj të gjithë sundimtarët e tjerë ulën kokën dhe u nënshtruan.

Rëndësia historike e kësaj beteje është tepër e veçantë për historinë e Perandorisë Osmane dhe të vendeve të Ballkanit. Fitorja e osmanëve në Betejën e Kosovës shënon një moment vendimtar në depërtimin përfundimtar të tyre në trevat ballkanike. Kjo ngjarje tejet dramatike, humbja e koalicionit ballkanik, solli dhe humbjen e lirisë dhe të pavarësisë të vendeve të Ballkanit, rënien e tyre nën vasalitetin osman dhe, më pas, dhe humbjen e çdo privilegji.

Në historiografinë serbe ngulet këmbë për ta trajtuar dhe paraqitur këtë betejë, edhe pse të humbur, si vepër, në radhë të parë, të serbëve, apo, kryesisht, të serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve, pra, vetëm të popujve sllavë të gadishullit, të udhëhequr nga knjaz Llazari. Mbivlerësimi i figurës së Llazarit në historiografinë serbe, i vendit dhe i rolit të tij në Betejën e Fushë Kosovës si figurë kryesore, ka nisur nga njerëzit e rrethit më të afërt familiar, nga vetë i biri, dhe prej kishës serbe. Llazari u shpall shenjt nga kisha pravosllave. Duke ecur në këtë rrugë historiografia serbe ka hyrë në rrugë pa krye dhe sot e kësaj dite është larg një vlerësimi objektiv të ngjarjeve të vitit 1389.

Përpyekjet e bëra në çerekun e fundit të shekullit të kaluar në historiografinë serbe për ta parë me sy kritik këtë moment dhe rolin e Llazarit të mbivlerësuar nga letërsia kishtare serbe dhe jo vetëm ajo, nuk u çuan më tej. Ndonjë autor, si Ruvarac, doli kundër mbivlerësimit të Llazarit të ngritur deri në legjendë, mbështetur në përralla dhe përrallëza popullore, pa vlerësuar burimet historike.³

Po këtë fat pati dhe ndonjë orvatje tjetër e bërë në mesin e viteve '70 të shek.XX për një rivlerësim mbi baza shkencore të rolit të Llazarit dhe të serbëve, përgjithësisht, në Betejën e Kosovës. R. Mihajlçiq, thekson se ky rol i tyre është mbivlerësuar për “shkak të mosnjohjes së materialeve” autentike (burimeve arkivore), “*për shkak të trajtimit të gabuar metodologjik të burimeve*”, “*për shkak të përpjekjeve që e vërteta historike mbi knjaz Llazarin të mos hedhë njollë mbi legjendat, mbi një gjë kombëtare*”⁴ Zëra të tillë të autorëve seriozë, të cilët përpiqeshin ta vinin

1998, 3-4.

³ Ilarion Ruvarac, *O Knezu Lazaru: raspravlja Ilarijon Ruvarac, arhimandrit*, Novi Sad: Srpska štamparija “Dra Svetozara Miletića”, 1887.

⁴ Rade Mihaljčić, “Knez Lazar i obnova srpske države”, në: *O knezu Lazaru*, Beograd:

kërkimin shkencor mbi baza metodologjike të drejta mbeten zëra të izoluar në korin e “*shkencës*” serbe, të tejngopur me paragjykime shoviniste dhe me prirje të theksuara antishqiptare.

Në kundërshtim me këto zëra të vetmuar, që kërkonin një trajtim objektiv të së kaluarës së serbëve, të zhveshur nga mitet, punimet e shumicës së historianëve serbë vijuan përpjekjet e fantazuara për të minimizuar, madje, shpesh për të mohuar hapur pjesëmarrjen e shqiptarëve, në përgjithësi, dhe të shqiptarëve të Kosovës, në veçanti, në këtë betejë. Shihet qartë, që këto qëndrime nuk kanë të bëjnë fare me shkencën, janë në kundërshtim me faktet e njohura prej kohësh. Historiografia serbe i kundërvihet një literature të tërë të përfaqësuar nga autoritete të studimeve ballkanologjike. Këta të mbështetur në burimet arkivore dhe letrare relevante që i referohen betejës së Fushë - Kosovës kanë përcaktuar, në mënyrë të padiskutueshme, karakterin mbarë ballkanik të kësaj beteje.

Kundërvënia e studiuesve serbë ndaj arritjeve të studiuesve objektivë lidhur me këtë temë është shprehje kuptimplotë dhe dëshmi e vënies së tyre në shërbim të një politike të caktuar shtetërore edhe sot kësaj dite serbomadhe. Ajo është pjesë përbërëse e atyre koncepteve shoviniste, politike kinse “shkencore, në të vërtetë, antishqiptare të qarqeve shoviniste, zyrtare dhe jo zyrtare, të Beogradit për ta paraqitur Kosovën si “*tokë të shenjtë serbe*” dhe “*djep të serbizmit dhe të shtetit serb*”.

E ndodhur përballë shtrembërimesh të paskrupullta të së vërtetës historike, historiografia shqiptare, qysh në mesin e shekullit të kaluar ka provuar në mënyrë të dokumentuar dhe të padiskutueshme, tashmë, pjesëmarrjen e shqiptarëve, përfshijë dhe ato të Kosovës, në këtë betejë. Gjithashtu, studiuesit tanë janë përpjekur të vënë në pah dhe vendin e tyre në këtë luftë të përbashkët të popujve të Ballkanit. Porse mbetet ende për të sqaruar rolin e tyre shumë të rëndësishëm në gjirin e koalicionit ballkanas dhe në fushën e betejës.

Pushtimi i Ballkanit, siç dihet, ka zgjatur, afërsisht, një shekull e një çerek. Po kaq ka zgjatur, afërsisht, dhe nënshtrimi i Shqipërisë, por me një vonesë jo të vogël prej afro një çerek shekulli në krahasim me vendet e tjera të gadishullit. Në fazën e parë, osmanët i lanë sovranët vendës në vendet e tyre, por, tashmë, si vasalë. Shembulli më shprehës i kësaj faze është ai i Bizantit, basileusi i të cilit u bë vasal i sulltanit që më 1372, tetëdhjetë e një vjet përpara se të binte Kostandinopoja dhe të zhdukej, bashkë me shtetin e vet, më 1453. Në fazën e dytë, pushtuesit e rinj i mënjanuan plotësisht

sundimtarët vendës dhe territoret e tyre i shndërruan në provinca të Perandorisë.

Më 1372 Jovan Paleologu V iu nënshtrua Muratit dhe e shoqëroi atë në një fushatë në Azinë e Vogël si vasal i përlur. Po në atë vit cari bullgar i Tërnovës Ivan Shishman bëri betimin solemn dhe i dha për grua sovranit osman motrën e vet, e quajtura Disislava “*shumë e lavdishmja*”. Për të libri sinodik i Tërnovës shkruan: “*Zonja Tamara, e bija e carit të madh Ivan - Aleksandër, zonjë e madhe, grua e emirit të shquar Amurat (Muratit), që iu dha këtij për të mirën e popullit. Duke shkuar atje, ajo ruajti besimin e vet ortodoks, shpëtoi popullin e saj, jetoi mirë dhe me devotshmëri, pastaj vdiq në paqe*”.⁵(?!)

Faktet e mësipërme bëjnë të qartë qëndrimin e atyre që kërkojnë të përvetësojnë merita që nuk i kanë pasur në frontin antiosman të asaj kohe. Për më tepër këto fakte tregojnë qartë se lufta osmano-ballkanike e atyre shekujve nuk ka pasur karakter fetar. Kontradiktat fetare kishin dalë në rrafsh të dyte. Nisur nga këto fakte studiuesi francez G. Kastelan arrin në përfundimin se aso kohe binte në sy mungesa shpesh e plotë e çdo ndjenje të solidaritetit kristian përballë osmanëve. Kjo rrethanë kishte arsyet e veta historike dhe politike me pasoja të ndjeshme negative të cilat duheshin kapërcyer. Rruga për te koalicioni ballkanas, aq i nevojshëm dhe i dëshiruar, nuk ka qenë e lehtë. Ajo flet për një trashëgimi historike mjaft të hidhur.

Konfliktet dhe luftërat e ashpra karakterizuan marrëdhëniet e principatave shqiptare me formacionet sllave, përkatësisht serbe, të trashëguara nga koha e perandorisë së Dushanit, të cilat vijonin të zotëronin ende mjaft toka shqiptare siç ishte Kosova. Megjithatë, përballë rrezikut më madhor osman, nuk munguan përpjekjet për kapërcimin e konflikteve lokale dhe bashkimin e forcave kundër tij. Në vitin 1384 është sundimtari shqiptar Gjini Bue Shpata ai që përpiket ta shkëpusë despotin serb të Janinës, Thoma Preljuboviçin, nga aleanca e tij me osmanët dhe e ftoi atë t'i bashkonin armët e t'i dëbonin turqit që kishin filluar të futeshin në Epir. Porse nuk mund dhe nuk duhet harruar se fjala është pikërisht për atë Th. Preljuboviçin e mirënjohur për urrejtjen e tij të thellë ndaj shqiptarëve. Ai me të drejtë u quajt, sipas vetë burimeve dokumentare të kohës, “*shqiptar-vrasësi*” (Albanitoktonos).⁶ Kronika e Janinës rrëfen se antishqiptarizmi i

⁵ Georges Castellan, *Histori e Ballkanit: shekulli XIV-XX*, Tiranë: Çabej, [1996], 65, sipas Ivan Dujčev, *Histoire de la Bulgarie: des origines à nos jours*, Sofia: Académie des sciences de Bulgarie, Centre national d'histoire, 1977, 236.

⁶ Leandros Vranoussis, *Tò Xronikòn tòn Iωαννίνων κατ' ἀνέκδοτον δημώδη ἐπιτομήν*, Athens 1965, 89.

tij patologjik arrinte deri te pasioni i tij makabër për të koleksionuar gjymtyrët e prera dhe sytë e nxjerra të shqiptarëve. Përveç kronikës në fjalë, emri i despotit të përbindshëm serb, i shoqëruar nga epiteti “*Albanitoktonos*”, është gjetur i gdhendur, sipas profesorit të Kembrixhit Donald M. Nicol edhe në një mbishkrim të kohës në kështjellën e Janinës.⁷

Megjithë këtë bagazh negativ të marrëdhënieve shqiptaro-sllave sundimtarët shqiptarë vlerësuan drejt gjendjen e krijuar me afrimin e rrezikut osman. Të vetëdijshëm për faktin që potencia e sundimtarëve sllavë ishte në rënie, ata përcaktuan drejt rrezikun e ri osman, si rrezik kryesor për vete dhe për të gjithë rajonin.

Edhe në veri dhe verilindje të trevave shqiptare, sado që këtu përvoja e trashëguar nga marrëdhëniet shqiptaro-sllave ishte dhe më e hidhur, shqiptarët mbajtën të njëjtin qëndrim. Mjafton të kujtojmë dënimet që parashikonte Zakoniku i car Dushanit për kthimin e shqiptarëve në ortodoksë sllavë dhe për sllavizimin e tyre.

Nuk kishte veçse pak vjet që kur Gjergji I Balsha kishte mundur serbët dhe boshnjakët, të komanduar nga Stefan Tverko, në Banat. Përballë rrezikut të ri meritë e vjetra, po t’i quajmë kështu, u lanë më një anë. Dhe në veri filloi të merrte trajtë, gjithashtu, një aleancë tjetër ushtarake midis zotit shqiptar të Shkodrës Gjergji II Balsha e mbretit Stefan Tverko të Bosnjës.⁸ Dhe kjo aleancë nuk ngeli në fazën e përpjekjeve dhe as në letër. Konkretizimi i parë i kësaj aleance, sipas kronistëve osmanë, ishte fitorja e bujshme e aleatëve mbi komandantin turk të Rumelisë, Lala Shahinin, në betejën e Trebinjës (1388).⁹ Rëndësia e kësaj fitoreje të parë mbi ushtrinë osmane qëndron në faktin se ajo provoi që e vetmja rrugë e efektshme për t’i bërë ballë rrezikut osman, ishte ajo e forcimit të frymës së bashkëpunimit midis sundimtarëve të Ballkanit që ndodheshin përballë të të njëjtit rrezik. Prandaj, mund të thuhet, se aleanca shqiptaro-boshnjake, pas një viti, u bë bërthama e boshtit të koalicionit të gjerë ballkanik të drejtuar nga Llazari i Serbisë, më 28 qershor 1389. Ky koalicion i mati forcat me ushtritë osmane të komanduara nga vetë sulltan Murati I në betejën fatale të Fushë Kosovës.

⁷ Donald M. Nicol, *The Despotate of Epiros 1267-1479: A Contribution to the History of Greece in the Middle Ages*, Cambridge: Cambridge University Press, 1984, 154.

⁸ *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, [Lajos Thallóczy; Konstantin Jireček; Milan Šufflay], vol.II, Vindobonae: Typis Adolphi Holzhausen, 1918, dok. 390, 426 (shënimet), 432.

⁹ Selami Pulaha *Lufta Shqiptaro-Turke në shekullin XV; burime Osmane* (Burime dhe materiale për historinë e Shqipërisë), Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1968, 78, 134 Neshriu dhe Bitlisi. [më tej: Burime Osmane].

Studiuesit turq të historisë ushtarake e kanë vlerësuar realisht arritjen e sendërtimitin e koalicionit antiosman ballkanik.¹⁰ Në të u arrit të bashkoheshin në të njëjtën ushtri kombe të ndryshme dhe që të gjithë ato u angazhuan në luftën e përbashkët kundër osmanëve. Krijimi i këtij koalicioni shënonte një fitore të rëndësishme politike të sundimtarëve ballkanas, pavarësisht se nuk arriti të shoqërohet dhe me një fitore në fushën e betejës. Me krijimin e këtij koalicioni u fitua dhe një përvojë tejet pozitive e cila duhej t'u fliste kohëve që po vinin pozitivisht dhe me forcë.

Karakteri mbarëballkanik i Betejës së Kosovës

Sipas kronikave osmane, pjesëtarët kryesorë të koalicionit ballkanas, pavarësisht nga rrezja e gjerë e sundimtarëve të gadishullit, të përfshirë në të ishin serbët, shqiptarët dhe boshnjakët. Oruçi shkruan se Llazarit mbledhi ushtarë nga vilajeti i Rashës dhe e thënë shprehimisht nga “*vendi i shqiptarëve*” si dhe nga çdo popullsi tjetër. Kuptohet në varësi të rrezes së shtrirjes së pushteti të tij.¹¹

Të dhënat e kronistëve osmanë se rreth Llazarit qenka krijuar një koalicion i gjerë i krishterë, në të cilin bënë pjesë shqiptarët e të tjerët, përpiqen t'i hedhin poshtë studiues serbë, me pretendimin se “të dhënat osmane janë bërë me qëllim për të rritur suksesin e palës osmane.(!)”¹² Për t'u vënë në pah është fakti që këto autorë kur iu intereson iu referohen gjerësisht këtyre burimeve, kur nuk u intereson ose i lënë në heshtje apo në pamundësi të kësaj vënë në dyshim saktësinë e tyre, si në rastin e më sipërm. Këtë realitet të përcjellë me besnikëri nga dëshmitarë të asaj kohe e kanë pranuar dhe mjaft autoritete të shkencave turkologjike dhe ballkanologjike. Në këtë kuadër ata kanë pranuar, gjithashtu, në mënyrë të padiskutueshme dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve në këtë betejë. Le të përmendim disa prej tyre. T. Zinkeisen e ka vlerësuar atë si luftë për jetë a vdekje për popujt e Ballkanit, ku morën pjesë serbë, boshnjakë, shqiptarë, hungarezë, bullgarë, vllahë, hercegovinas e tjerë.¹³ Ky bashkim i sundimtarëve ballkanikë, sipas tij, erdhi si nevojë e shtytje e brendshme që ndiente secili prej pjesëmarrësve

¹⁰ Binbaşı Mükerrrem, *Kosova 1389 Türk ordusunun eski seferlerinden bir imha muharebesi (6 krokisi mevcut)*, İstanbul: Askeri Matbaa, 1931, 30.

¹¹ Petrika Thëngjilli, “Vlera e burimeve osmane për Betejën e Kosovës”, *Studime historike*, nr. 4, 1989, 158; sipas S. Pulaha, *Burime Osmane*, 34.

¹² Petar Tomac, *Kosovska bitka*, Beograd: Vojnoizdavački zavod, 1968, 101; R. Taçki, *Boj na Kosovu*, 46, sipas: Thëngjilli, “Vlera e burimeve osmane”, 159.

¹³ Johann Wilhelm Zinkeisen, *Geschichte der europäischen Staaten* [Geschichte des osmanischen Reiches in Europa], Hamburg: F. Perthes, 1840, 249 - 260. LM88, 14.

në koalicion përballë rrezikut osman. Si një lidhje popujsh e ka vlerësuar Betejën e Kosovës edhe Hammer. Ushtria e forcave ballkanike, shkruan ai, përbëhej nga “serbë, bullgarë, boshnjakë, shqiptarë, vllehë, polakë dhe sipas historishkruesve osmanë, edhe prej hungarezve”¹⁴

Të njëjtën përmbajtje, si “*betejë popujsh*” i ka dhënë kësaj ngjarjeje edhe një nga njohësit më në zë të historisë mesjetare të popujve të Ballkanit, i cili është, njëkohësisht dhe mik i madh i serbëve, K. Jireček. Ai, mbi bazën e burimeve të pasura arkivore dhe letrare, shkruan : “turqve u qëndronin përballë serbët që ishin nën udhëheqjen e L Lazarit, ... boshnjakët nën udhëheqjen Vojvodës Vlatko Hraniqit. Krahas tyre luftonin bani i Kroacisë, bullgarët... trupat ndihmëse të Vojvodës Mirca dhe shumë zotërinj nga Shqipëria, nga të cilët pothuajse pak prej tyre e panë prapë atdheun e tyre”.¹⁵ Faza e fundit flet qartë për vendosmërinë me të cilën u angazhuan shqiptarët e të tjerët në këtë betejë. Dhe gjithë kjo, siç do të shihet, ka arsyet e veta.

Në Betejën e Kosovës kanë marrë pjesë deri dhe shqiptarë nga Shqipëria e Jugut. Autorë grekë njoftojnë se në këtë betejë morën pjesë krahas serbëve dhe “luftëtarë nga Dardanët e Shqipërisë... nga Akrokeraunët, nga Epiri dhe nga Bregdeti i Adriatikut”.¹⁶ Në fushën e betejës gjeti vdekjen dhe Teodori II Muzaka.¹⁷ Nga ky autor bizantin, rezulton që në Jug arbit e Mesjetës shtriheshin, në Epir dhe nga Akrokerauni dhe nga Bregdeti. Edhe kaq sa u citua më sipër nga studiuesit më autaritativë të historisë osmane dhe ballkanase flasin qartë se sa të paqëndrueshme janë përpjekjet thujse konstante të historiografisë serbe, mesjetare dhe moderne, për ta paraqitur Betejën e Fushë Kosovës si aksion, kryesisht, serb apo shumë, si aleancë serbo - boshnjake - kroate, duke përjashtuar pjesëmarrësit e tjerë, veçanërisht, shqiptarët.

Pjesëmarrja e shqiptarëve në koalicionin ballkanik dhe kontributi i tyre, jo i vogël, në radhët e tij dhe në fushën e betejës, janë të qarta për këdo dhe të pamohueshme. Gjergj II Balsha përfaqësohej në koalicion, sipas përlllogaritjesh të përafërta, me një ushtri e cila arrinte në shkallën e 1/5 të

¹⁴ Joseph Freiherr von Hammer-Purgstall, *Geschichte des Osmanischen Reiches*, vol. I, C.A. Hartleben, 1834, 176. LM88, 15.

¹⁵ Konstantin Josef Jireček, *Geschichte der Bulgaren*, Prague, 1986, 342-344.

¹⁶ Jerakos, “Hronikon peri tes Tourkon basileias”, *Bibliotheca graeca* medii Evi: nune primum edidit Constant Sathas, Volume 1, En Benetiai: Tupois tou Chronon, 1872, 247-248.

¹⁷ Charl Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues*, Berlin: Weidmann, 1873.

të gjitha forcave aleate. Për këtë arsye dhe fjala e tij në Këshillin e luftës ishte me shumë peshë.

Në kundërshtim me faktet, studiues serbë pretendojnë se Gjergji II Balsha, dhëndër i Llazarit dhe baxhanak me Vukun,¹⁸ për motive personale nuk paska marrë pjesë në betejë. Fakti, që ai përmendet, përveçse në burime të tjera, dhe në këngët serbe si i tillë, hedh poshtë pretendime të këtilla, të cilat synojnë të mohojnë jo vetëm pjesëmarrjen e shqiptarëve të Kosovës në këtë betejë por dhe të kontestojnë dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve të viseve të tjera. Përkundrejt gjithë këtyre përpjekjeve që s'kanë asgjë të përbashkët me shkencën pjesëmarrjen aktive të shqiptarëve në Betejën e Fushë Kosovës e pranojnë dhe studiues të sotëm si bullgarja B. Cvetkova¹⁹ dhe francezi A. Dyselje.²⁰

Nuk ka dyshim që aleanca shqiptaro-boshnjake përbënte bërthamën që hapi rrugën për sendërtimin e një koalicioni dhe më të gjerë në shkallë ballkanike. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e shqiptarëve në të nuk mund të mohohet kurrësi. Përballë qëndrimeve nihiliste apo minimizuese të historiografisë serbe del detyra që të vihet në pah pesha që shqiptarët bartën realisht në atë kuadër të luftës antiosmane, roli që ata luajtën në të gjithë zhvillimet e asaj kohe të vrullshme dhe dramatike, edhe pse jo tragjike.

Për të dhënë përmasat e plota të këtij kontributi kërkohet që të sqarohet mirë, në radhë të parë, se çfarë përfaqëson nga ana etnike pjesëmarrja e Kosovës në këtë koalicion. Që herët autorët grekë njoftojnë se në këtë betejë morën pjesë përveç serbëve dhe viset e tjera të Shqipërisë dhe, madje, dhe “*luftëtarë nga Dardanët e Shqipërisë*”.²¹ Pra, Jerakos dëshmon që Dardania, pra, Kosova, i përkiste Shqipërisë dhe se banorët e saj, pavarësisht se ndodheshin nën sundimin e një princi serb, siç ishte Vuk Brankoviçi, ishin shqiptarë.

Po ashtu, humanisti dubrovnikas, abati benediktin i manastirit të Shën Andreas dhe Shën Jakobit në Vishnjicë, Alovsius Cervinus Tubero (1459-1527) apo Tuberon Krijeviq, siç njihet përgjithësisht në historiografi, në veprën e tij të njohur të botuar pas vdekjes me titull “*Komente për kohën e vet...*”,²² qysh në fillim të shekullit XVI, përmend si pjesëmarrës të betejës,

¹⁸ Vladimir Mošin. “Samodržavni Stefan knez Lazar i tradicija nemanjićkog suvereniteta od Marice do Kosova”, *O Knezu Lazaru*, Beograd, 1975, 33.

¹⁹ Geroičnata sprotiva na balgarite protiv turskoto našestvije, *Sofija*, 1960, 49.

²⁰ Alain Ducellier, *La façade maritime de l'Albanie au Moyen Age: Durazzo et Valona du XIe au XVe siècle*, Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1981, 498.

²¹ Jerakos, “Hronikon peri tes Tourkon basileias”, 247-248.

²² Ludovicus Cervarius Tubero, *Dalmatae Abbatis C Commentariorum Rebus Quae Temporibus Eius Illa Europae Parte Quam Pannonii Turcae Eorumq Ue Finitimi Incolunt*

dardanët, ilirët dhe maqedonasit. Nuk ka dyshim, siç pranon dhe ndonjë autor serb, që në këtë rast kemi të bëjmë me përdorimin e emërtimeve antike të popullsisë të vjetra.²³ Se ku i futë humanisti dubrovnikas serbët në këto emërtime antike nuk është detyra jonë ta shkoqisim. Por një gjë është e padyshimtë që serbët nuk hyjnë as midis ilirëve dhe as midis dardanëve, që kanë ekzistuar në këto treva që para ardhjes së sllavëve aty. Se sa ata mund t'i japin vetes të drejtën të përdorin ashtu sikurse dhe sot emërtimin historiko-geografik të Maqedonisë antike për të gjetur veten në Betejën e Kosovës, ajo prapë mbetet detyra e tyre.

Pra, pavarësisht se kronistët bizantinë, osmanë dhe perëndimorë i përmendin shqiptarët mesjetarë në Kosovë me emrat e tyre antikë si pjesëmarrës aktivë nuk kanë pse në betejën e vitit 1389, dëshmitë e mësipërme e provojnë katërcipërisht një fakt të tillë. Kjo heshtje deri vonë ka kërkuar shpjegim. Përgjigjja e kësaj pyetjeje është fare e thjeshtë dhe gjendet te identifikimi i shqiptarëve të Kosovës me pushtetin serb. Kronistët nisheshin, si për të gjitha trevat e tjera të gadishullit, nga koncepti i formacionit politik ku ata bënin pjesë. Dhe një pjesë e mirë e popullsisë shqiptare të Kosovës qe përfshirë në shtetin serb të Vuk Brankoviçit. Nën këtë koncept politik shtetëror trajtohen nga këto kronistë, jo vetëm shqiptarët, po dhe popullsitë e tjera që bënin pjesë në Perandorinë Bizantine.

Dokumentimi mbi bazën e fakteve dhe të dhënave të ndryshme burimore të dorës së parë i pranisë së shqiptarëve në Kosovë si popullsi e lashtë autoktone, pasardhëse e drejtpërdrejtë e popullsisë së vjetër të ilirëve dardanë, e ka bërë tashmë të tepërt çdo diskutim rreth rreshtimit të padiskutueshëm të shqiptarëve të Kosovës, qoftë dhe si nënshtetas të Vukut, në rreshtat e para të luftëtarëve të Betejës së Kosovës. Një realitet i tillë demografiko-historik i Kosovës në fund të shekullit XIV ka qenë i prekshëm dhe i pranuar dhe nga ndonjë autor serb si I. Mishkoviç.²⁴

Kjo, mund të jetë, veç të tjerash, dhe arsyeja që libri i tij, i botuar më 1933, iu nënshtrua një diskutimi në vitet 60-ta të shek.XX. P. Tomac në librin e tij, kushtuar po Betejës së Kosovës, e kritikon Mishkoviçin për gabimin e rëndë, që paska bërë, duke lënë shteg për të menduar se në radhët e ushtrisë së Vuk Brankoviçit, zotit të atëhershëm të Kosovës dhe të Metohisë, mund të ketë pasur edhe shqiptarë kosovarë. Këtij fakti që gjen

Gestae Sunt, Libri Undecim, Frankofurti: Marne und Aubry, 1603.

²³ Miroslav Pantić, "Knez Lazar i Kosovska bitka u staroj književnosti Dubrovnika i Boke Kotorske", *O knezu Lazaru*, Beograd, 1975, 345.

²⁴ *Kosovska bitka 15. juna 1389. godine : sa dva snimka, jednom slikom u slogu i pet karata u prilozima*, red. Jovan Mišković, Beograd: Grafičko umetnički zavod Planeta", 1933.

tashmë konfirmim nga shumë anë, ai i kundërvihet me pohime të pa mbështetura standarte : “Në atë kohë Kosova dhe Metohia, shkruan Tomac, paska qenë origjinale serbe” ²⁵

Është thënë në studimet tona se të mohohet apo të vihet në dyshim pjesëmarrja e popullsisë shqiptare të Kosovës në këtë luftë kundër një armiku që i kishte ardhur në vatër, siç e mohon Tomac,²⁶ do të ishte po aq pa kuptim sa të vihej në dyshim edhe pjesëmarrja e serbëve të vendosur dora-dorës në Kosovë pas pushtimit serb (shek.XII) dhe e Vuk Brankoviçit që ishte atëherë zot i vendit. Sigurisht që edhe një arsyetim i tillë mund të bëhet. Porse, në pamundësi për ta mohuar, nuk mungojnë përpjekjet e vetë serbëve për ta denigruar pjesëmarrjen e Vukut në Betejë. Nuk mund të mos shënojmë faktin që në eposin serb Vuk Brankoviçi paraqitet, me të padrejtë, si tradhtar në Betejën e Kosovës. Ndërsa ngrihet knjaz Llazari, humbja kërkohet t’i faturohet Vukut që komandonte dardanët shqiptarë. Për autorin turk Zuhuri Danëshman, një gojëdhënë e tillë është shumë e dyshimtë për t’u besuar. ²⁷ Përkundrejt këtij non sensi vlen të sillet në kujtesë, që në epikën serbe ngrihet si hero krajl Markoja, i cili siç dihet, i dha fund jetës përkrah dhëndrit të Brankoviçëve, sulltan Muratit të dytë, si vasal i tij. Autori serb Pantiq lidhur me pretendimet e Krijeviçit, të cituara më sipër, pohon se me emërtimet antike të pjesëmarrësve të Betejës, që përdorte ai kishte parasysh “luftëtarët serbë” dhe “nënshtetasit e Llazarit” ²⁸ Porse autori në fjalë duhej t’i kishte shkruar deri në fund problemit se kush fshihet, në të vërtetë, pas termit “nënshtetas të Llazarit”. Një gjë e tillë bëhet edhe më e detyrueshme për faktin se autori i ka veçuar “luftëtarët serbë” midis “nënshtetasve të Llazarit”. Një realitet i tillë atij i ka dalë, me sa duket, qoftë dhe në mënyrë të pavetëdijshme. Prandaj nuk kemi përse të mos pajtohemi me autorin M. Pantiq, i cili pas emrave antikë sheh vetëm “luftëtarë serbë” dhe “nënshtetas të Llazarit”, përderisa principata e Llazarit përbëhej jo vetëm nga serbë, por dhe nga shqiptarë dhe popullsi të tjera. Pra, forcat shqiptare pjesëmarrëse aktive në betejë duhet t’i kërkojmë edhe brenda vetë forcave të komanduara drejt për së drejti nga Llazari.

Pra, pjesëmarrja e shqiptarëve në Betejën e Kosovës është shumë e gjerë. Në të u përfshinë shqiptarët që ishin nën sundimin e princave

²⁵ Tomac, *Kosovska bitka*, 167-168, Lm. 21.

²⁶ Po aty, 130, 168.

²⁷ Zuhuri Danışman, *Osmanlı İmparatorluğu tarihi* (14 Cilt Takım), İstanbul: Z. Danışman Yayınevi, 1965 196.

²⁸ Luan Malltezi, “Mbi pjesëmarrjen e shqiptarëve të Kosovës në Betejën e vitit 1389 dhe përkatësinë etnike shqiptare të Milosh Kopiliqit”, *Studime historike*, nr. 4, 1989, 141.

shqiptarë që nga Balshajt e Muzakajt e më gjerë, shqiptarët e Kosovës që ndodhej nën sundimin e Vuk Brankoviçit si dhe shqiptarët që qenë nën sundimin e L Lazar Hrabljanoviçit, të cilët me sa duket, nuk kanë qenë të paktë. Një nga këta mund të ketë qenë dhe Mirosh (Millosh) Kopili aq i përmendur.

Kënga popullore e shqiptarëve për Betejën e Kosovës është dëshmi më vete është kënga e pasardhësve të pjesëmarrësve ndër më aktivët në këtë betejë dhe me një hero, Miroshin, të dalë nga gjiri i vet. Fjalët e fundit të këngës popullore shqiptare, ashtu siç na e përcjellë G. Elezoviç, flasin për largimin e një pjese të popullsisë autoktone shqiptare të Kosovës, e cila ka shpresë të kthehet kur të “*çartet turku sikur na*”.²⁹

Rreth Mirosh Kopilit është zhvilluar një debat që vijon edhe sot e kësaj dite për sa i takon përkatësisë etnike këtij heroit tjetër të Kosovës, të rënë në fushën e betejës. Çështja nuk mund të thjeshtohet aq shumë sa të thuhet se në këtë mes fjala është për një vrasës ordiner. Milloshi ka vrarë një nga sulltanët më të mëdhenj të Turqisë, Muratin I, i cili me forcat e tij theu koalicionin e forcave ballkanike. Nga ana tjetër, pretendimet e zakonshme rreth prejardhjes së tij serbe, bëjnë pjesë në atë mori përpjekjesh për të justifikuar orekset shoviniste serbomëdha në drejtim të Kosovës dhe më gjerë. Një hero kaq i madh mund dhe duhej të ishte nga Kosova, ku u zhvillua kjo beteja edhe pse e humbur. Dhe ai duhej t'i përkiste, sipas logjikës serbomadhe popullsisë mbizotëruese të atyshme e menduar serbe. Nga ana tjetër, vërtetimi i shqiptarësisë së tij është një argument më tepër rreth pranisë së shqiptarëve në Kosovë që para fundit të shekullit XVII. Sigurisht, që sot pas vënies në qarkullim të një dokumentacioni të shumtë që provon praninë dhe mbizotërimin e shqiptarëve në Kosovë para vendosjes së sundimit osman në këto treva, një argument i tillë mund të duket i tepërt. Edhe në rrethanat e reja, të shoqëruara me një radhë studimesh për demografinë historike të Kosovës paraosmane dhe osmane, me të cilat u hodhën poshtë në mënyrë dërmuese mitet serbe, ky debat ka vlerën e vet. Ecuria e përpjekjeve të ethshme serbe për përvetësimin etnik edhe të Kopiliqit është një provë tjetër e falsitetit të miteve të ngritura nga serbët në adresë të trevave shqiptare të pretenduara prej tyre.

Një autor serb si për sa i takon prejardhjes së Millosh Kopiliqit, pohon se ai është “*dinarian*” i dalë prej simbiozës serbo-shqiptare, pra,

²⁹ Gliša Elezović, “Jedna arnautska varijanta o boju na Kosovu”, *Arhiv za Arbanasku u Starinu, Jezik i Etnologiju*, t. 1, nr 1–2, Beograd 1923, 66–67; Malltezi, “Mbi pjesëmarrjen”, 142.

“*Ballkanas i serbizuar*”.³⁰ Këtë emër F. Arapi e lidh me emrat shqiptarë Mëhill, Mhill, Mill, Milo.³¹ V. Çajkanoviq, konstaton që më 1912, në kushtet e Luftës së Parë Ballkanike, se “kulti i Milosh Kopiliqit është dukshëm i fortë ndër shqiptarët dhe ata e quajnë si heroin e tyre”. Kjo, konkludon ky autor, nuk qe thjeshtë përhapje e kultit të Milloshit, “*të pjesës jugperëndimore të popullit tonë, veçanërisht të Malit të Zi, tek elementi që nuk është serb*”.³²

Vrasja e Muratit e bëri Milosh Kopiliqin hero. Emrin e tij e gjejmë në kronikat osmane, që te Ashik Pashëzadeja që shkroi në kohën e Bajazitit të parë (1484).³³ Pra, emrin e tij e gjejmë të dokumentuar që në shek XV. Përpyekjet e vonuara të literaturës tregimtare dhe folklorike serbe për vënien në pah a më mirë të thuhet për përvetësimin e tij nga ana etnike kanë shpjegimin e vet. Pra, pikërisht këtë hero real historik kronikat serbe të kohës nuk e shënojnë asgjëkund.³⁴ Kostiqi që konstatoi këtë fakt mendon ta justifikojë këtë, duke ia vënë fajin murgjve, të cilët, sipas tij shënojnë vetëm sundimtarët. Në të vërtetë, kronikanët, siç ndodh dhe me kronistët osmanë, në shënimet e tyre pasqyrojnë jo vetëm mbretërit dhe komandantët e mëdhenj që qëndrojnë pranë tyre por dhe heronjtë e betejave. Në këtë drejtim Ashik Pashëzadeja nuk tregohet i kursyer as nga kampi osman dhe as nga kampi kundërshtar. Murgjit e manastireve serbe, kronikanë të këtyre ngjarjeve, normalisht, nuk kanë pse të bëjnë përjashtim nga ky rregull. Ata në kronikat e këngët e tyre nuk mungojnë të ngrenë dhe dezertorët e popullit serb. Milloshi shqiptar, jo rastësisht, është lënë fillimisht jashtë tyre. Mundet që edhe të ketë hyrë një herë dhe pastaj është nxjerrë jashtë. Këta murgj serbë nuk mund t’i lejonin vetes që përballë knjazit të tyre, që kishte rënë në fushën e betejës, të ngrinin një hero jo serb, një hero shqiptar pikërisht nga Kosova. Aq më tepër fjala ishte për një hero që rridhte nga një popullsi të cilën carët serbë ia kishin nënshtruar perandorisë së tyre. Ata kujtuan se vetëm kalimi i kohës, domethënë harresa, mund t’u lejonte atyre që ta përvetësonin etnikisht dhe këtë hero. Ky përvetësim duhej t’i jepte shkëlqim heroit të tyre serb Llazarit. Këtë dëshmon dhe fakti që edhe në

³⁰ Dragutin Kostić, "Miloš Kopilić-Kobilić-Obilić", *Revue Internationale des Etudes Balkaniques* 1-2 (Beograd, 1934-1935), 232-254; Malltezi, "Mbi pjesëmarrjen", 143.

³¹ Fatos Arapi, *Këngë të moçme shqiptare*, Tiranë, 1986, 217.

³² Veselina Čajkanovića, "Motivi prve arnautske pesme o boju na Kosovu", *Arhiv za Arbanasku u Starinu, Jezik i Etnologiju*, t. 1, nr 1-2, Beograd 1923, 67-70.

³³ Selami Pulaha, "Luftërat shqiptaro - turke në veprat e kronistëve dhe historianëve osam në shek. XV-XVII", *Studime Historike*, nr. 1, 1968, 121-153 ; *Burime Osmane*, 61-65.

³⁴ Malltezi, *Beteja e Fushë – Kosovës*, 79-99.

epikën e tyre historike serbët nuk kanë këngë kushtuar vetëm Milloshit. Miloshi në to përmendet midis të tjerëve, nëpër këngët e quajtura Llazarica.

Madje, në këto këngë Milloshi jo vetëm është në sfond. Në oborrin e Llazarit ai paraqitet i huaj për ambjentin serb. Milloshi, sipas vetë këngës serbe, është i dashur për masën e njerëzve, madje, dhe për bullgarët. Atë knjazi e konsideron kundërshtar.³⁵

Interesi i serbëve për Miloshin, siç është vënë re nga studiuesit, është zgjuar nga fundi i shekullit XVIII. Serbët, shkruan Haslluk, ose sepse harruan origjinën fshatare të mbiemrit të Milloshit, ose sepse kishin frikë se banorët e Kopiliqit mund të deklaronin, se ai, sikundër dhe ata, ishte me origjinë shqiptare, filluan që para shekullit XVIII ta nxjerrin emrin e tij nga serbishtja Kobilja (Pelë) dhe shpikën legjendën se ai ishte ushqyer nga një pelë.³⁶ Sipas Jirečekut në shek. XVIII u pa se nuk ishte i përshtatshëm një emër i tillë që lidhej me pelën.³⁷ Në shek. XVIII historianët P. Julinaç dhe V. Petroviç i dhanë atij emrin Obiliq nga serbishtja obilje bollëk, tepri, në kuptimin e një njeriu me shumë cilësi.³⁸ Kjo është arsyeja e mirëfilltë që Millosh Kopiliqi mungon në kronikat serbe. Siç njoftojnë kronistët e tyre,³⁹ osmanët me këtë fushatë synonin të thyenin qëndresën e serbëve, shqiptarëve dhe boshnjakëve, të cilët, në bashkëpunim midis tyre i kishin shkaktuar një disfatë të rëndë ushtrisë osmane në Trebinjë të Bosnjës më 1387. Ata bëjnë fjalë për një koalicion shumë më të gjerë. Në të përveç mbretit të Bosnjës dhe sundimtarit të Shkodrës shqiptare, mori pjesë dhe sundimtari i Serbisë, Llazar dhe forca të tjera. Sipas Bitlisis në qendër të rreshtimit të forcave të koalicionit ballkanik në fushën e betejës u vendosën forcat e komanduara nga Llazari, majtas Vuk Brankoviçi, me nënshtetasit e tij shqiptarë të Kosovës, dhe djathtas mbreti i Bosnjës me Levend Ogllunë.⁴⁰

Sadeddini thotë të kundërtën lidhur me vendosjen e forcave të ndryshme në të dy krahët e Llazarit.⁴¹ Shqiptarët dhe aleatët e tjerë ishin rreshtuar në të dy anët e qendrës. Përkrah Muratit qenë rreshtuar edhe kontigjentet e vasalëve të tij të krishterë si Kostantini, princi bullgar i Velbuzhdit, serbi Marko Kraljeviq, armik i Llazarit. Mungonte basileusi i

³⁵ Ferhat Cakaj, *E vërteta mbi "eposin serb", refleksion eseistik*, Tiranë : Botimet Toena, 1998, 87-92.

³⁶ Po aty.

³⁷ Konstantin Jireček, *Istorija Srba*, II, Beograd, 1927, 91.

³⁸ Malltezi, "Mbi pjesëmarrjen", 148.

³⁹ *Burime Osmane*: Bitlisi, 135; Shukrullahu, 27; Sadeddini, 254.

⁴⁰ Po aty, Bitlisi, 143.

⁴¹ Po aty, Sadeddini, 255.

Bizantit Jovani V, për faktin e thjeshtë se nuk ishte në gjendje të mblidhte e të mobilizonte trupat e veta.⁴²

Pas disa sukseseve të ushtrisë së koalicionit, sipas Neshriut, të krishterët thyen në fillim krahun e majtë të ushtrisë osmane që udhëhiqej nga Jakupi. Pra, ky sukses u dedikohet luftëtarëve të komanduar nga Vuk Brankoviçi në të cilët bënin pjesë dhe shqiptarët. Por, me një herë ndërhyri Bajaziti, i cili mori komandën e krahut të djathtë dhe rivendosi situatën.

Mbështetur në këto kronika dhe në burime të tjera të pa shënuara, autorë të mëvonshëm turq kanë dhënë një pasqyrë mjaft të saktë të kësaj beteje. Sipas historianes Fatma Alije, në betejën e zhvilluar më 15 shaban 791,⁴³ krali serb L Lazar u vendos në qendër të luftimit me kalorësit e vet të korracuar. Ndërsa nipi i tij, gjenerali i famshëm, siç e quan autorja, Brankoviq me ushtarët e tij serb dhe shqiptarë u vendos në krah të djathtë të formacionit të luftimit, ndërsa mbreti i Bosnjës me forcat e veta dhe ato bullgare u vendos në krah të majtë.

Autori tjetër turk Ali Hajdar, i cili i ka vënë vetes për detyrë të mohojë pjesëmarrjen e shqiptarëve në këtë betejë, për hir të interesave të momentit, politike dhe ideologjike, të xhonturqve të porsaardhur në pushtet, na thotë se nën komandën e Brankoviçit ishin forca serbe dhe latine. Nuk ka dyshim që me forca latine duhet të kemi parasysh para së gjithash, shqiptarët katolikë. Që në kohë të Pjetër Bogdanit dhe deri vonë në Ballkanin Perëndimor feja katolike quhej fe e shqiptare, "*arbanashka vera*". Porse ky fakt nuk përjashton faktin tjetër që edhe midis atyre forcave të konsideruara serbe, për shkak të besimit të tyre jo katolik, kishte të rreshtuara dhe forca shqiptare të besimit ortodoks pravosllav. Dihet tashmë presionet të cilave u ishin nënshtruar shqiptarët e ndodhur nën sundimin serb, që nga koha e car Dushani, për të ndërruar besimin. Gjeneral Brankoviçi bëri një sulm të rreptë në krahun e Jakup Çelebiut. Ushtarët e tij nga Anadolli nuk e përballuan dot këtë sulm të furishëm dhe u shturën. Porse nuk ia mbathën. Prapa tyre kishin murin e deveve dhe të ngarkesave të rënda. Domethënë se s'kishin nga të iknin. Sulltani kishte ardhur ose për të fituar ose për të vdekur. Ushtarët të cilët nuk kishin nga t'ia mbathnin u detyruan të hyjnë në përleshje me thika.⁴⁴

⁴² Castellan, *Histori e Ballkanit*, 68.

⁴³ Sipas Ali Hajdarit, beteja është zhvilluar më 14 shaban 791 (15 qershor 1389) ditë e hënë. Shiko: *Kosova Meydan Muharebesi hk. Ayrıntılı bilgi için bkz. Ali Haydar*, Kosova Meydan Muharebesi, Kostantiniye, 1328, 40.

⁴⁴ Fatma Aliye, *Tarih-i osmaniye'nin bir devre-i mühimmesi Kosova zaferi* - Ankara hezimeti, Istanbul, 1331, 61-63.

Për herë të parë në këtë betejë nga të dy palët u përdorën në Europë armët e zjarrit, topat dhe dyfeqet. Por me që nuk qenë perfeksionuar ende nuk u përfitua shumë prej tyre. Ushtarët turqë pa e njohur mirë terrenin kishin depërtuar deri në Mramor dhe Çiçavicë të Drenicës. Aty u vra dhe i vëllaj i Bajazitit, Jakup Çelebiu.⁴⁵

Dëshmi e shkallës së lartë të vetëdijes etnike të luftëtarëve shqiptarë

Me shumë interes për trajtimin me kompetencë e të mbështetur në burime, kryesisht, osmane paraqitet studimi i Majorit Mykerem. Ky punim është botuar më 1931. E theksojmë këtë fakt sepse ky autor dhe shumë të tjerë, pas revolucionit qemalist, të xhveshur nga ideologjitë panturkiste e panosmaniste, nuk kanë, tashmë, asnjë kompleks lidhur me pjesëmarrjen e shqiptarëve në këtë betejë.

Sipas majorit Mykerem, beteja është zhvilluar më 27 gusht 1389.⁴⁶ Shqiptarët, vijon autori në fjalë, e pranuan menjëherë propozimin për të marrë pjesë në koalicionin ballkanas. Si rrjedhim përballë osmanëve u krijua një lidhje e përbërë nga serbë, shqiptarë dhe boshnjakë.⁴⁷ Ai e pranon hapur që krahu i djathtë i forcave të Llazarit i komanduar nga nipi i tij Vuk (Duk) Brankoviqi, përbëhej nga ushtarë serbë dhe shqiptarë.⁴⁸ Pra, ushtarët latinë të përmendur nga Ali Hajdar ishin shqiptarë. Ndërsa midis serbëve vlen të theksohet se, sipas traditës teokratike mesjetare bizantine, sllave dhe osmane, të identifikimit të fesë me kombësinë, nuk mungonin dhe shqiptarë ortodoksë. Barrën kryesore të sulmit të forcave ballkanike e përballoi krahu i djathtë i ushtrisë osmane, i komanduar nga Jakup Çelebiu. Arsytet e këtij fakti autori i sheh në disa faktorë, të cilët ai i përmbledh në tre momente:

1) Krahu i djathtë i forcave osmane që vendosur në shpate mbizotëruese dhe përballë këtij krahu ishin vendosur ushtarët bullgarë, që kishin ngrënë disa herë dajak nga forcat osmane, si dhe forcat boshnjake, të cilat për shkak grindjesh etnike dhe rivalitetesh, nuk donin që Llazari të dilte fitimtarë.

2) Përballë grupit qendror tepër të fuqishëm të forcave osmane ndodheshin ushtarët e Llazarit, të kombësive të ndryshme jo fort të sigurta, jo fort të besueshme.

⁴⁵ *Kosova Meydan Muharebesi hk. Ayrıntılı bilgi için bkz. Ali Haydar, 45, 55.*

⁴⁶ Binbaşı Mükerrrem, *Kosova 1389*, 25.

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ Po aty, 23.

3) Me që krahu i djathtë i serbëve ndodhej në vend të sheshtë krijonte një superioritet ndaj pozitës së grupeve të tjerë, sepse lejonte sulmin si për sa i përkiste terrenit, nga ana e fushës, ashtu dhe për sa i përkiste besimit që ekzistonte gjithsesi ndaj ushtarëve serbë dhe shqiptarë. Për këto arsye u vendos që sulmi bazë të zhvillohej nga ana e grupit të djathtë të forcave serbe kundër krahut të majtë osman. Dhe këtë sulm e zbatoi me një forcë dhe vrull shumë të madh Vuk Brankoviçi që ishte komandanti i këtij grupi. Ushtarët serb dhe shqiptar, që përbënin forcat e këtij grupi, e kishin të qartë, siç vëren majori Mykerrem, se luftonin, në radhë të parë dhe drejt për së drejti, për atdheun dhe pavarësinë e vet. Prandaj, sulmuan furishëm me të gjitha forcat që kishin.⁴⁹ Pra, ata, shqiptarët, latinë dhe ortodoksë, luftonin, edhe pse nën Brankoviçin, për Kosovën, për tokën e vet. Përballë këtij sulmi të furishëm të njerëzve të vetëdijshëm për misionin e tyre, Jakup Çelebiu, fillimisht, u tërhoq. Tashti, grupit të qendrës, të komanduar nga Llazari, iu krijua mundësia që të hidhej në sulm.

Mbi këtë moment të betejës, me sa duket, është përhapur fillimisht lajmi që koalicioni ballkanik e fitoi betejën me Muratin. Mendohet që ky gëzim i parakohshëm të jetë mbështetur në një letër që mbreti i Bosnjës, Tvërko I, i dërgoi qytetit të Trogirit më 1 gusht 1389.⁵⁰ Porse sulmi i Jëlldërimit bëri që të thyheshin boshnjakët. Atëherë, edhe Jakup Çelebiu kaloi në sulm. Forcat e koalicionit ballkanas të rrethuara nga të dy anët filluan të tërhiqen.⁵¹ Fitimtari i Betejës së Kosovës u bë Bajaziti, i biri princshës greke Elena, pra, nipi i basileusit Jovan V.⁵² Në Fushën e Betejës ranë knjaz Llazari, sulltan Murati dhe hero i Kosovës Millosh Kopili. Shumica e prijësve shqiptarë siç na e thotë Jireçeku si, mjaft të tjerë nuk u kthyen në vendet e tyre pra mbeten në luftë. Serbia e mundur në Kosovë, vijoi të ekzistonte në formën e një shteti vasal. I biri i Llazarit, Stefani, u bë “despot” dhe e vulosi nënshtrimin e vet, duke e dërguar të bijën, Maria Dhespinën, në harem të Sulltanit.⁵³ Pra, nënës greke të Bajazitit iu shtua dhe një princshë serbe, më pas dhe një greke, duke theksuar “bizantinizimin” e oborrit të sulltanit.

Në këtë vazhdë është trajtuar Beteja e Kosovës e vitit 1389 dhe më pas nga historiografia turke.⁵⁴ Ky trajtim nuk mund të mos përfillet sa here

⁴⁹ Po aty, 27.

⁵⁰ M. Braun, *Die Schlacht auf dem Amselfelde in geschichtlicher und epischer Überlieferung*, Leipzig, 1937, p. 10 - 11.

⁵¹ Binbaşı Mükerrrem, *Kosova 1389*, 27.

⁵² Castellan, *Histori e Ballkanit*, 69.

⁵³ Castellan, *Histori e Ballkanit*, 70.

⁵⁴ Ismail Hami Danišmend, *Izahli Osmanli Tarihi Kronolojisi*, cilt I, M. 1258 - 1512 / H.

që do të trajtohet kjo ngjarje e rëndësishme e historisë Ballkanike. Më pas, në betejën e zhvilluar në fushën e Rovinës afër Krajovës, përtej Danubit, krahas Bajazitit, ishin princat serbë Stefani, biri i Lllazarit, Marko, i biri i mbretit Vukashin, sundimtar i Prilepit, dhe Kostandin Dejanoviq, princ i Maqedonisë Perëndimore. Mbreti Marko heroi këngëve popullore serbe, u vra në radhët e osmanëve.

Më 25 shtator 1396 gjatë rrethimit të Vidinit koalicioni kristian, hungarez e të tjerë, pësoi disfatë, midis të tjerash, nga ndërhyrja e Bajazitit, “*Rrufesë*”, nga indisciplinimi i kalorësve francezë si dhe nga hyrja në betejë e trupave të freskëta të despotit serb Stefan, 5000 vetë, të cilit vasali ia kishte sjellë sovranit dhe dhëndrit të tij, njëkohësisht.

Disfata e Bajazitit nën muret e Ankarasë më 22 korrik 1402 shënoi fundin e asaj që mund të quhet “*Perandoria e Parë Osmane*”, e cila ia zgjati edhe për një gjysmë shekulli mbijetesën e Bizantit. Ata që ia shkurtuan jetën kësaj perandorie qenë vetë të krishterët, të krishterët, të cilët, kinse, erdhën për ta ndihmuar. Nga ana tjetër, Perandorisë Osmane ia kushtuan jetën e tyre mjaft të krishterët, të cilët u vunë nën urdhrat e sulltanëve osmanë. Në tetor 1448 Brankoviçi nuk iu bashkëngjiti forcave të Hyniadit ndërsa Skënderbeu arriti më vonësë. Në kohën kur fuqia e Perandorisë Osmane qe përsëri në rritje dhe do të arrijë kulmin e saj, qe vetëm Shqipëria e udhëhequr nga Skënderbeu që i bëri ballë atij rrebeshi. Me luftën e tyre 25-vjeçare shqiptarët u vunë në mbrojtje të qytetërimit perëndimor, në mbrojtje të Rilindjes Evropiane dhe të kulturës së saj. Nga sa u trajtua më sipër bie poshtë miti serbomadh për Betejën e Kosovës, del qarte karakteri multietnik i dy koalicioneve ndërluftuese. Shqiptarët e ndodhur nën sundimin e perandorëve bizantinë dhe princave serbë vasalë të sulltanit dhe nën ndikimin e kishave ortodokse bizantine e pravosllave nën ndikimin e krerëve fetarë shumica e tyre u rreshtuan në kampin antiosman. Në këtë betejë u përfshinë shqiptarët nga të gjithë krahinat, që nga zotërimet e Lllazar Hrblljanoviqit e të Vuk Brankoviqit e deri dhe nga viset më jugore. Pra, ajo pati një rrezatim mjaft të gjerë në mjedisin arbënor.

Në Fushë Kosovë luheshin fatet e të gjithëve. Një fitore do të sillte lehtësimin e presionit osman mbi vendet ballkanike, një humbje përkundrazi, do të sillte, siç edhe solli, fillimin e sundimit pesëshekullor osman. Gjon Muzaka konkludon me të drejtë, se disfata në Fushë Kosovë shënoi tragjedinë e Shqipërisë. Pikërisht këtë kishin parasysh krerët

656 - 918, Tŷrkiye Yayĭnevi, 1947, 77-81; Zuhuri Danĭşman, *Bŷyŷk Tŷrk Tarihinden Osmanlĭ Tarihi*, ikinci cilt, 1956, 189-203; *Resimli haritalĭ Mufasssal Osmanlĭ Tarihi*, 1, bir heyet tarafından yazılmiştĭr, 133-140.

shqiptarë të mbarë trevave shqiptare kur u rreshtuan në koalicionin ndër ballkanik në betejën e zhvilluar në Fushën e Mullenjave në qendër të Kosovës shqiptare.

Ishte, pikërisht, kuptimi i thellë i vendit dhe roli që beteja e Fushë Kosovës do të luante në momentin e dhënë për fatin e të gjithëve e të secilit, që i shtyu shqiptarët më se shumti të merrnin pjesë aktivisht dhe të mbanin një pjesë të mirë të peshës të rëndësishme të saj.⁵⁵ Ishte dhe vendi ku u zhvillua ajo, siç e pranojnë dhe autorë turq, që e rritën në shkallë të lartë angazhimin e shqiptarëve në këtë betejë vendimtare për fatet e përbashkëta të ballkanasve. Pavarësisht se përfundoi me një disfatë të thellë dhe me pasoja fatale për të gjithë rajonin, dhe ndoshta dhe bash po për këtë arsye, kjo betejë duhej të kishte mbetur simbol i nevojës dhe i domosdoshmërisë së bashkëpunimit dhe të miqësisë ndërmjet popujve ballkanikë. Porse në të vërtetë nuk ndodhi kështu.

Sundimtarët e popujve fqinjë tanë, në radhë të parë serbët, duke vuajtur nga kompleksi i inferioritetit të trashëgimisë historike iu përveshën, në radhë të parë, klerikët e tyre, punës për të krijuar një traditë historike serbe që nuk i kalon dhe sot e kësaj dite, shumë të 1300 vjetët. Për këtë ata u përpoqën vijimisht të përvetësojnë sa të jetë e mundur nga historia e lashtë dhe mesjetare e Ballkanit. Në mënyrë të veçantë atyre iu interesoi të “bëjnë” histori me këngët e tyre në ato vende që ato i pretendojnë si tokë e lashtë serbe si djep i serbizmit, duke filluar me Kosovën e deri në Shkodër. Në këtë frymë ata i kushtuan një vëmendje të veçantë Betejës së vitit 1389. Edhe pse një betejë e humbur, ata u përpoqën ta përvetësojnë tërësisht luftën që u bë aty nga i gjithë koalicioni ballkanas. Në pamundësi për t’ia arritur kësaj ata u përpoqën të përjashtojnë shqiptarët e sidomos shqiptarët e Kosovës prej kësaj lavdie të ngritur mbi disfatën. Në këtë rrugë ata kanë hyznizuar jo vetëm disfatën dhe i kënduan, gati gati, si fitores, por i kënduan dhe përuljes e, madje, dhe tradhtisë. Mjafton të rikujtojmë dhe një herë, me këtë rast, këngët për kraljeviç Markun.

Në të gjithë këtë qëndrim të historiografisë, të folkloristikës, të kronikave dhe të vetë këngëve serbe vërejmë një qarkullim të tezave shoviniste nëpër qarqet “shkencore” serbe. Gjithandej në to bien në sy përpjekje të sforcuara për të argumentuar historinë, a, më mirë të thuhet, për të përligjur edhe sot e kësaj dite, pretendimet shoviniste të serbëve me anë të folklorit dhe të kronikave kishtare.

⁵⁵ Pëllumb Xhufi, “Shqiptarët e Jugut në Betejën e Fushë - Kosovës”, *Studime historike*, nr. 4, 1989, 149-153.

Në këtë vazhdë ndeshemi me shumë falsifikime dhe pretendime të autorëve, të cilët rreken ta paraqesin, jo vetëm Kosovën, por dhe treva të tjera shqiptare, deri edhe Shkodrën, si djep të kombit dhe të lëvizjes kombëtare serbe. Përveç argumenteve historike dhe karakteri origjinal i këngëve historike dhe, sidomos, i baladave shqiptare në përjasje me derivatet e tyre sllave, përgënjeshtrojnë falsifikimet e të ashtuquajturës shkencë serbe rreth problemit etnik të Kosovës.

Tendencioziteti i kësaj lloji shkence për të bërë histori me këngë, për të piketuar vende dhe figura historike serbe në trevat e lashta të shqiptarëve autoktonë, në Kosovë, në Shkodër, sa më pranë brigjeve të Adriatikut, për t'i shndërruar baladat shqiptare në këngë popullore historike serbe del gjithandej qartë. Dhe nuk ka si të ndodhë ndryshe, për derisa historia, shumë shumë, 1300-vjeçare e serbëve në Ballkan nuk mbështet më tej pretendimet e tyre shoviniste. Epika e tyre historike nuk mund të arrijë sikurse epika shqiptare deri te baladat, të zhytet në thellësitë e pafund dhe magjepsje të epikës sonë legjendare. Lidhja artificiale dhe e paargumentuar, që u bëhet cikleve të këngëve serbe me emrin e Kosovës dhe Betejën e vitit 1389 flet qartë për vënien e kësaj “shkence” në shërbim të përligjjes së një politike të caktuar.

Trajtimi i Betejës së Kosovës, përmes falsifikimesh sistematike të paskrupullta, në kundërshtim me të vërtetën historike tregon qartë se kemi të bëjmë me keqtrajtimin dhe shpërdorimin e fakteve, të kronikave, të të dhënave burimore, të folklorit në shërbim të një politike të caktuar në dëm të kulturës, të shkencës dhe të marrëdhënieve miqësore midis popujve fqinjë. Politikë kjo si ajo e Millosheviçit, i cili sulmin kundër Krahinës autonome të Kosovarëve dhe kundër kosovarëve, që po luftonin për të drejta të barabarta me popujt e tjerë në ish Jugosllavinë titiste, e filloi me një miting në Fushën e Mëllenjave, para Gazi Mestanit të sulltan Muratit. Në përkujtim të humbjes së pavarësisë së Serbisë ai niste luftërat që çuan në humbjen, zhbërjen e Jugosllavisë.

Ish ministri i Millosheviçit Vuciq, presidenti i sotëm i Serbisë në përkujtim të ditës së Shën Vedit (Vidovdanit) u drejtohej serbë ve kudo që janë:

“Vidovdani është ora e takimit tonë, jo vetëm me të kaluarën. Shumë thonë se Kosova është vendlindja e tyre dhe pika kryesore e jetës sonë. Edhe nëse nuk është plotësisht e vërtetë, është sigurisht një nga më të rëndësishmet, sepse vëzhguesit e Kosovës po e rishikojnë tërë historinë tonë nga Kosova deri më sot”. Siç shihet, dhe sot e kësaj dite, vijohet sikurse deri dje!

Disfata e koalicionit serbo-shqiptaro-boshnjak përfundoi me disfatë me pasoja katastrofike për popujt e Ballkanit. Pikërisht për këto arsye prapë prapë përfaqëson një ngjarje me përmasa të mëdha mësimdhënëse. Megjithatë, dhe sot e kësaj dite, nuk u vlerësua asnjëherë si e tillë dhe, madje, po keqpërdoret edhe sot si më parë. Në këtë frymë po të vijmë në vitet këtij shekulli do të shohim që në vend të ripërtëritjes së kësaj tradite pozitive të përpjekjeve për bashkëpunim të popujve ballkanikë përballë rrezikut të përbashkët, të arritur në kushtet e separatizmit feudal, shovinistët serbë me orekset e tyre të shfrenuara përdorën përçarjen e popujve ballkanikë. Një politikë e tillë e mosnjohjes së kombit shqiptar dhe e copëtimit të trojeve shqiptare, fillon që me Kongresin e Berlinit (1878). Sa antishqiptare dhe në perspektive antiballkanike e antievropiane ishin vendimet e marra në atë forum e treguan qartë luftimet e përgjakshme të Lidhjes së Prizrenit në mbrojtje të Plavës e Gucisë, të Hotit e Grudës si dhe të Ulqinit. Më pas, në vitet 1909-1912 shqiptarët luftuan të vetëm kundër sundimit xhonturk në kryengritje të fuqishme të njëpasnjëshme. Me luftimet e tyre dhe sidomos me kryengritjen e tyre të përgjithshme të vitit 1912 shqiptarët qëndruan, në fakt të vetëm, në ballë të procesit përfundimtar të çlirimit të Gadishullit Ballkanik nga zgjedha osmane. Thirrjes së udhëheqësve shqiptarë si Hasan Prishtina e të tjerëve për bashkëpunim nuk iu përgjigjen as qeveritarët ballkanas dhe as forcat politike fqinje më të interesuara për një bashkëpunim të tillë. Me luftën e tyre që mori përmasa të pazakonta, dhe arriti deri në operacione strategjike për çlirimin e qyteteve, kryengritësit shqiptarë përshpejtuan fundin e këtij sundimi në kontinentin evropian. Autorë të huaj pranojnë pa mëdyshje që ishin kryengritjet shqiptare që përshpejtuan dhe realizimin e Aleancës Ballkanike, tashmë qëllimisht, pa shqiptarët. Sepse shqiptarët dhe trevat e tyre konsideroheshin plaçkë lufte, pjesë e trashëgimit osman, për ta ndarë midis tyre.

Edhe më vonë midis dy luftërave botërore, fqinjët ballkanikë i përjashtuan shqiptarët nga Pakti Ballkanik duke i quajtur kufij të shqiptarë “*jashtë ballkanikë*”, duke pranuar dhe ndonjë shtet gjysmë ballkanik!

Sipas traditës popullore dhe kishtarë serbe kjo betejë është zhvilluar në një ditë të shenjtë të kishës serbe, të quajtur Vidovdan. Në përvjetorin e kësaj dite krisën të shtënat e revolverit të studentit serb Gavrillo Princip në Sarajevë, më 28 qershor 1914, të cilat shërbyen si pretekst për t'i vënë flakën Evropës.

Më 28 qershor 1989, duke përkujtuar Vidovdanin, dhe duke festuar 600-vjetorin e Betejës së Kosovës të humbur, në frymën shoviniste të këtyre

tezave u manifestua fuqishëm në aktivitete të shumëllojshme që u zhvilluan me muaj me radhë gjatë vitit 1989 për të festuar (!) 600-vjetorin e kësaj beteje, realisht, të humbur. Me këto festime shovinizmi serb mori hov për të nënshtruar popullin shqiptar të Kosovës për të shtypur luftën e tij për të drejta kombëtare të barabarta me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Madje, në këtë përvjetor mori hov shovinizmi serb për të nënshtruar plotësisht dhe popujt e tjerë vëllezër sllavë. Duke shpërfytyruar dhe shpërdoruar kujtimin dhe mesazhin e Betejës së Kosovës të vitit 1389, me rastin e 600-vjetorit të saj, në vend të sigurimit të bashkëpunimit të popujve ballkanikë u hap rruga për luftëra të reja ballkanike.

Lufta e gjatë dhe e mundimshme e popullit shqiptar, pas luftës së zhvilluar nga populli kroat e populli boshnjak, dhe sidomos lufta e vitit të fundit e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës e demaskoi përfundimisht nacional shovinizmin serb. Kjo luftë i imponoi botës demokratike të rreshtohet përkrah popullit shqiptar në mbrojtje të parimeve elementare demokratike.

Nënshtrimi i regjimit të Millosheviqit, çka duhet të nënkuptojë dhe shkëputjen e Serbisë nga të gjitha ëndrrat shoviniste të trashëguar nga mesjeta e errët, besohet se do të hapte një epokë të re në marrëdhëniet ndër ballkanike. Që këtë shpresohet se duke filluar nga 28 qershor 1999, në këtë 610-vjetor të Betejës së Kosovës do të fillojnë të për popujt Ballkanit perëndimor jo vetëm të atyre sllavë por dhe për shqiptarët jo sllavë një epokë e re: epoka e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit mbi bazën e interesave të ndërsjella. Është për të ardhur keq që gjaku i derdhur jo vetëm për t'u çliruar nga sundimi Osman, por, sidomos për shqiptarët, dhe për të shpëtuar nga lakmitë e atyre që mbi gërmadhat e perandorive të përmbysura të osmanëve dhe të habsburgëve, kërkonin të ringrinin perandoritë e perënduara në një kohë edhe më të hershme, perandoritë e car Dushanit apo të Bizantit.

Nuk është vështirë të kuptohet, se çfarë ëndërrojnë politikanë dhe shtetarë që ende shkojnë e vendosin kurora me lule në varrin e Esad pashë Toptanit të strehuar nga të parët e tyre nga varrezat e Parisit në Kalamejdan. Ky është tregues mjaft shprehës se mbi ç'baza kërkojnë të zhvillohen marrëdhëniet me Shqipërinë anëtare të NATO-s dhe që pret të hyjë në BE. Mesazhi historik i Betejës së Kosovës mbetet një mesazh i shpërfytyruar dhe i keqpërdorur mbrapsht!

SUMMARY

Gazmend SHPUZA

ALBANIANS AND THE BATTLE OF FUSHË KOSOVA

The paper deals with the battle of Kosovo 1389 a comprehensive study drawn from Byzantine, Turkish, Serbian and European sources that dealt with the battle. The Battle of Kosovo took place on 15 June 1389 between an army led by the Prince Lazar Hrebljanović and an invading army of the Ottoman Empire under the command of Sultan Murad. The battle was fought on the Kosovo , about 5 kilometers northwest of the modern city of Pristina. The armies of a large coalition of the peoples of the Balkans, led by Prince Lazar Hrebljanovic, were pitted against each other, in which the Albanians, on the one hand, and the forces of the Ottoman Turks, on the other, participated extensively. In the history of these peoples this battle marks the culmination of their common resistance to the threat of Ottoman invasion. The victory of the Ottomans in the Battle of Kosovo marks a crucial moment in their final penetration into the Balkans. This extremely dramatic event, the loss of the Balkan coalition, brought about the loss of freedom and independence of the Balkan countries, their fall under Ottoman vassalship and, subsequently, the loss of every privilege.

Byzantine, Ottoman, and Western chroniclers mention medieval Albanians in Kosovo by their ancient names as active participants. From early times the Byzantine authors report that in addition to the Serbs and other areas of Albania took part in this battle and even "fighters from the Dardanians of Albania". Reliable historical accounts of the battle are scarce. The bulk of both armies were wiped out, and Lazar and Murad were killed. Both armies were effectively wiped out, however, balkanian manpower was depleted and had no capacity to field large armies against future Ottoman campaigns, which relied on new reserve forces from Anatolia. Despite the fact that it ended in a deep defeat and with fatal consequences for the whole region, and perhaps for this very reason, this battle should have remained a symbol of the need and necessity of cooperation and friendship between the Balkan peoples. But that did not really happen.